

KONTROLLI FINANCIAR ËSHTË ÇËSHTJE E DREJTË DHE LIRIE

nga Yllka PULASHI - Audituese e lartë,

botuar në gazetën "Rilindja Demokratike", më 07 janar 2014.



Kontrolli i mënyrës se si institucionet shtetërore dhe në veçanti qeveria përdor paratë publike ka qenë gjithnjë një çështje e lidhur drejtpërdrejt me të drejtën dhe lirinë. E tillë u ideua në fillim të shekullit të 14-të në Anglinë e asaj kohe, vendi që kishte miratuar një kartë të të drejtave si Habeas Corpus, dhe e tillë vijon sot në të gjithë botën. Saktësisht, si auditim i financave u zyrtarizua nga Mbretëresha Elisabeta e Parë në vitin 1559. Detyra e institucionit të kontrollit financiar të ngritur nga mbretëresha atë botë ishte kontrolli i të gjitha pagesave që bënte ministri i Financave (Sekretari i Thesarit). Ishte provuar se Habeas Corpus e shekullit të 13-të, që garantonte gjyq të ndershëm dhe të drejtë për çdo të akuzuar, hiqte pushtetin absolut të mbretit dhe mbronte disa liri themelore të njeriut nuk mund të jetësohej në qoftë se askush nuk do të kontrollonte mënyrën se si shpenzoheshin paratë nga shteti.

Shumica e thyerjeve të ligjit, e mohimit të një drejte, e abuzimit të një pushteti lidhen në një mënyrë ose në një tjetër me shpërdorimin e parasë publike. Sot kjo gjë është e qartë për të gjithë siç të gjithë e kanë të qartë se Shqipëria vit pas viti rrit vëmendjen ndaj kontrollit financiar dhe mjeteve që i vihen në dispozicion atij për të qenë superiorë në këtë betejë. Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion i ngritur nga Kushtetuta e vendit dhe këtë përgjegjësi ai nuk mund ta ushtrojë në qoftë se nuk do të përfshijë në këtë betejë të gjitha burimet njerëzore që mund të kontribuojnë. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka dëshmuar gjithë këto vite se suksesi qëndron tek përfshirja, qëndron te trajnimi dhe ndjekja e parimeve më të mira të auditimit që vijnë nga Bashkimi Evropian dhe e udhëhequr nga parimet e INTOSAI-t. Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik është një koncept i zhvilluar më së shumti nga Komisioni Evropian. Ai përbëhet nga principe të sistemit të Menaxhimit

Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, i krijuar me qëllim kontrollin, auditimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit kombëtar dhe buxhetit dhe fondeve të Bashkimit Evropian, dhe gjithashtu për të mbështetur vendet candidate në reformat e sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Në këtë mënyrë, pritet që vendet candidate të themelojnë dhe të zhvillojnë një sistem të kontrollit të brendshëm financiar, i cili të përmbajë konceptet që janë zhvilluar në këtë fushë nga Bashkimi Evropian bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të vendeve evropiane.

Konrolli i Lartë i Shtetit vazhdon të jetë pjesë e qenësishme e reformave në ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar. Pavarësisht kësaj, Shqipëria gjendet ende një vend me shumë shpërdorime të parasë publike, një vend ku liria ekonomike mbetet e sulmuar dhe ku për pasojë të drejtat jo gjithnjë e gjejnë rrugën e tyre. Por kjo nuk mund të jetë një fushatë, as pjesë e një fushate dhe as një seri fushatash. Ky është një proces që nuk mund të tejkalohet atë që bën e gjithë shoqëria. Padyshim që institucionet e auditit financiar dhe në veçanti Kontrolli i Lartë i Shtetit do të jenë në krye, kanë detyrimin të jenë në krye, por shoqëria duhet të nisë të reagojë edhe ajo si një ndërgjegje publike.

Vit pas viti dhe kohë pas Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe në veçanti në dy vitet e fundit, dërgon në organet e drejtësisë shpërdorime të ndryshme dhe jo gjithnjë ato janë trajtuar me përkushtimin që meriton mbrojtja e parasë së të gjithëve, mbrojtja e të drejtës dhe dinjitetit të të gjithëve. Kjo nuk është një arsye për të mos vazhduar, kjo është një arsye për të qenë më të prerë sepse nuk është në vetvete çështje auditimi, por të drejtë.